VENDIM
Nr. 8, datë 29.1.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KOMITETIT NDËRSEKTORIAL PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT NR. 7, DATË 19.2.2020, "PËR MIRATIMIN E DISA SHTESAVE DHE NDRYSHIMEVE TË FOTOVE TË PARALAJMËRIMEVE PËR EFEKTET SHKATËRRUESE TË DUHANIT, SI DHE SPECIFIKIMET E VENDOSJES SË TYRE NË PAKETË"

Komiteti Ndërsektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit (KNMSHPD), me pjesëmarrjen e anëtarëve, si më poshtë:

1. Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kryetar – znj. Ogerta Manastirliu;
2. Zëvendësministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, anëtar – znj. Nina Guga;
3. Zëvendësministrit të Brendshëm, anëtar – z. Besfort Lamallari;
4. Zëvendësministrit të Turizmit dhe Mjedisit, anëtar – znj. Ornela Çuçi;
5. Kryetarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, anëtar – z. Gentian Sala;
6. Drejtorit të Institutit të Shëndetit Publik, anëtar – znj. Albana Fico;
7. Kryeinspektorit Shëndetësor Shtetëror, anëtar – znj. Vjollca Braho;
8. Drejtorit të Policisë Bashkiake, Tiranë, përfaqësues i autorizuar – z. Toni Beni.

Pasi analizoi me vëmendje të gjithë problematikat e ngritura nga grupet e interesit përcjellë me shkresë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale por edhe gjatë takimit të zhvilluar në ambientet e ministrisë vendosi si vijon:

1. Miratimin e disa ndryshimeve të vendimit nr. 7, datë 19.2.2020, të KNMSHPD-së sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMITETIT NDËRSEKTORIAL PËR
MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT
Ogerta Manastirliu

Neni 1

Në nenin 2, "paralajmërimet e përgjithshme dhe mesazhet informuese në produktet e duhanit", bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Pika 3, ndryshohet si në vijim:

"3. Për paketat në formë kuboide, vetëm një nga paralajmërimet shëndetësore të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të shfaqet në pjesën e poshtme të njërës prej sipërfaqeve anësore të njësisë së paketës. Paralajmërimi shëndetësor ose mesazhi informues duhet të zërë jo më pak se 50% të sipërfaqes anësore në të cilën është printuar. Për produktet e duhanit, që nuk janë të vendosura në paketim kuboid, mesazhet duhet të shfaqen në atë pjesë të paketimit që garanton vizibilitet të plotë të paralajmërimit. Paralajmërimet e përgjithshme dhe mesazhi informues do të rrotullohen në mënyrë të tillë që të sigurohet shfaqja e tyre në mënyrë të rregullt."

b) Në fund të pikës 5, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Sipërfaqja e paralajmërimeve të përgjithshme dhe mesazhet informuese do të rrotullohen në mënyrë të tillë që të sigurohet shfaqja e tyre në mënyrë të rregullt. Sfondi i paralajmërimeve të përgjithshme do të jetë i rrethuar nga një bordurë e zezë, e cila do të jetë 1mm brenda hapësirës së

parashikuar për secilin paralajmërim. Bordura nuk duhet të ndërhyjë në asnjë mënyrë te përmbajtja e paralajmërimeve."

Neni 2

Në nenin 3 "Paralajmërimet shëndetësore të kombinuara për produktet e duhanit" bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Pas pikës 2, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. në rastet kur pulla e akcizës e përdorur për qëllime fiskale vendoset në skajin e sipërm të një paketimi, paralajmërimi i kombinuar shëndetësor që do të shfaqet në sipërfaqen e pasme mund të pozicionohet direkt nën pullën e akcizës."

b) Pas pikës 7, shtohen pikat 8 dhe 9, me këtë përmbajtje:

"8. Paralajmërimet e kombinuara do të rrotullohen në mënyrë të tillë që të sigurohet shfaqja e tyre e rregullt, duke zbatuar kombinimet e përcaktuara në shtojcën 3, të këtij vendimi.

9. Sipërfaqja e paralajmërimeve të kombinuara do të jetë i rrethuar nga një bordurë e zezë, e cila do të jetë 1mm brenda hapësirës së parashikuar për secilin paralajmërim. Bordura nuk duhet të ndërhyjë në asnjë mënyrë te përmbajtja e paralajmërimeve.".

Neni 3

Paralajmërimet shëndetësore për purot dhe cigarillot

1. Paralajmërimet shëndetësore për produktet e duhanit për tymosje përveç cigareve, duhanit me dredhje dhe duhanit për nargjile.

2. Paralajmërimi shëndetësor duhet të shfaqet në dy sipërfaqet më të mëdha të njësisë së paketës dhe të çdo paketimi të jashtëm.

3. Paralajmërimi shëndetësor duhet të zërë 30% të sipërfaqes së njësisë së paketës dhe të çdo paketimi të jashtëm.

4. Paralajmërimi shëndetësor duhet të respektojë kërkesat e specifikuara në nenin 2, pika 5, të këtij vendimi. Paralajmërimi shëndetësor do të rrethohet nga një bordurë e zezë, e cila do të jetë jo me pak e 1 mm dhe do të jetë jashtë sipërfaqes së rezervuar për paralajmërimet shëndetësore. Teksti i paralajmërimit shëndetësor duhet të jetë paralel me tekstin kryesor të vendosur në sipërfaqen e dedikuar për këto paralajmërime.

5. Në rastet kur paralajmërimi nuk mund të printohet me makineri për shkak të proceseve prodhuese atëherë paralajmërimi mund të shtypet në një etiketë dhe të ngjitet në paketim, me kusht që të jetë i palëvizshëm.

Neni 4

Në vendimin nr. 7, datë 19.2.2020 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve të fotove të paralajmërimeve për efektet shkatërruese të duhanit, si dhe specifikimet e vendosjes së tyre në paketë", fotot me nr. 1, 2, 11 dhe 13, shfuqizohen.

Neni 5

Pas nenit 10, shtohet neni 11, me këtë përmbajtje:

"Neni 11

Dispozita tranzitore

1. Produktet e duhanit që nuk plotësojnë kushtet e këtij vendimi nuk do të lejohet të importohen apo prodhohen pas datës 5.3.2022, por do të lejohen të tregtohen në pikat e shitjes të pakicës deri në datën 5.6.2022.

2. Prodhuesit dhe importuesit e produkteve të duhanit do të lejohen të importojnë, prodhojnë dhe shesin produktet e duhanit në përputhje me kërkesat e këtij vendimi dhe përpara datës 5.3.2022, në mënyrë që të mundësohet një tranzicion sa më efikas nga paketimet aktuale në paketimet me kushtet e reja të parashikuara në këtë vendim.".